



Në bazë të Ligjit për Qeverisje Lokale Ligji Nr. 03/L-040, neni 17 (pika b); Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, neni 10 (pika 2.1), neni 11, dhe neni 17 përmbajtja e Planeve Rregulluese të Hollësishme dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më 31 gusht 2015, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR HAPJEN E SHQYRTIMIT PUBLIK TË DRAFT - PLANIT TË HOLLSISHËM RREGULLUES “QENDRA E VJETËR E QYTETIT”

Neni 1

1.1. Me këtë vendim shpallet në shqyrtim publik, draft – Plani Rregulluese i Hollësishëm (P.Rr.H) “Qendra e Vjetër e Qytetit”

Neni 2

2.1. Shqyrtimin publik i draft P.Rr.H “ Qendra e Vjetër e Qytetit ” vihet në dispozicion publikut për shqyrtim dhe komente.

2.2. Projekt planet të parapara me ligj i nënshtrohen konsultimeve, shqyrtimeve publike dhe komenteve para se këto plane të finalizohen.

2.3. Të gjitha propozimet dhe vërejtjet që paraqiten nga publiku brenda mënyrës dhe afatit kohor të përcaktuar do të përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

Neni 3

3.1. Vendi i prezantimit publik të draft P.Rr. H “Qendra e Vjetër e Qytetit” do të jetë në qendrën kulturore “Mensur Zyberaj“, Rahovec.

3.1.1. Ekspozimi i draft P.Rr.H “ Qendra e Vjetër e Qytetit ” do të bëhet në qendrën kulturore “Mensur Zyberaj“, Rahovec .

3.2. Shqyrtimi publik i draft P.Rr.H “Qendra e Vjetër e Qytetit ” do të zgjatë **30 ditë**.

3.3. Shpallja e shqyrtimit publik të draft P.Rr.H “Qendra e Vjetër e Qytetit” do të bëhet së paku në tri gazeta të përditshme, WEB faqen e internetit të Komunës dhe nëpërmjet mjeteve tjera publike të informimit së paku **8 ditë** para fillimit të shqyrtimit publik.

Neni 4

4.1. Shqyrtimi publik të draft P.Rr.H “Qendra e Vjetër e Qytetit” organizohet nga Komuna në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Ligj.

Neni 5.

5.1. Me këtë vendim parashihen sigurimi i kushteve teknike dhe financiare që nevojiten gjatë kohës së shqyrtimit publik të draft P.Rr.H “ Qendra e Vjetër e Qytetit ”.

Neni 6


6.1. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrotjtje Mjedisit.

Neni 7

7.1. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në web faqen e komunës.

01 Nr. 3090
Rahovec, 31.08.2015

Kuvendi i Komunës së Rahovecit



Kryesuesi i Kuvendit

Nahit Elshani